



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / *Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta*

Ministry of Culture, Youth & Sports

Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe
Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive

KOMUNIKATË PËR OPINIONIN PUBLIK

04 Prill 2022

Prishtinë

Incidenti i rëndë në ndeshjen e futbollit ndërmjet KF Gjilani dhe KF Ballkani

Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive e ka përcjellë me shqetësim dhunën e shfaqur dje në ndeshjen e futbollit ndërmjet KF Gjilani dhe KF Ballkani, dhe e dënon ashpër dhunën e ushtruar nga tifozët e KF Gjilani ndaj portierit të KF Ballkani.

Përgëzojmë Policinë e Kosovës dhe Prokurorinë e Shtetit për reagimin e tyre të shpejtë, që ka rezultuar me identifikimin dhe arrestimin e disa personave të dyshuar për këtë incident të rëndë, ku dy prej tyre janë për vepra penale ndërsa të tjerët për kundërvajtje.

Këshilli kërkon nga të gjitha Federatat dhe klubet sportive në Kosovë, dhe në veçanti nga të gjithë organizatorët e ngjarjeve sportive, që të zbatojnë me përpikëri rregulloret dhe kriteret teknike gjatë procesit të aprovimit të objekteve të caktuara sportive për zhvillimin e ngjarjeve sportive.

Gjithashtu, Këshilli kërkon nga Federatat, respektivisht komisionet përkatëse për aprovimin teknik të objekteve sportive, si edhe delegatët që caktohen nga organizatat sportive për drejtimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të ngjarjeve sportive, që në rastet kur nuk ofrohen kushtet adekuate të sigurisë të mos lejojnë

prezencën e tifozëve, apo sipas nevojës të mos lejojnë zhvillimin e ngjarjes sportive pa u plotësuar kushtet përkatëse.

Këshilli dënon edhe dhunën e shfaqur dje në ndeshjen e futbollit të Ligës së Tretë (ndeshja e vlefshme për javën e 13-të), ndërmjet Bashkimit dhe Besës, me ç ‘rast futbollistët e skuadrës së Bashkimit nga Krusha e Madhe e Rahovecit, kanë sulmuar fizikisht gjyqtarin e kësaj ndeshjeje, me ç ‘rast ka qenë e nevojshme ndërhyrja e Policisë së Kosovës.

Këshilli kërkon nga organet përkatëse në kuadër të Federatës së Futbollit të Kosovës që me përkushtim maksimal të analizojë dhe të vlerësojë gjithçka që ka ndodhur gjatë incidenteve të djeshme dhe konform dispozitave përkatëse të shqiptojnë dënimet adekuate për përgjegjësit e ngjarjeve të djeshme.

Këshilli është i përkushtuar maksimalisht që në koordinim me të gjitha institucionet përkatëse ligj zbatuese të bëjë gjithçka që është e mundur për t’i mbajtur huliganët jashtë fushave të sportit, ndërsa portierit të sulmuar të KF Ballkanit i uron shërim dhe rikthim të shpejtë në fushën e lojës.

Këshilli iu bën thirrje të gjitha Federatave, klubeve sportive, organizatorëve të ngjarjeve sportive, si dhe grupeve të tifozëve që të distancohen nga të gjitha format e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, dhe të ofrojnë bashkëpunim me Këshillin si dhe organet tjera shtetërore për t’i parandaluar këto dukuri negative.

Me respekt,

Besim Kelmendi

Kryetar i Këshillit për Sport

Tel: +383 44 666 913 (edhe në Viber)

Email: keshillipersport@rks-gov.net

Web: <https://mkrs-ks.org/?page=1,176>